




**Rruga ime drejt një fillimi të
suksesshëm në kopshtin e fëmijëve**

Dhurojani fëmijës tuaj një fillim të mirë në kopshtin e fëmijëve. Të gjithë fëmijët kanë dëshirë të shkojnë në kopshtin e fëmijëve, sepse atje mund të bëjnë këto aktivitete, që përkojnë tamam me moshën e tyre: të luajnë, të bëjnë punë krijuese, të hulumtojnë, të zbulojnë, të kërkojnë, të ushtrojnë, të provojnë, të kalojnë kohë me bashkëmoshatarët, të flasín, të qeshín, të këndojnë, të kërcejnë me ta, të dëgjojnë tregime, të zbulojnë botën e vet dhe të përgatiten mirë për shkollën dhe për jetën e tyre!

Kopshti i fëmijëve nuk fillon vetëm me ditën e parë të shkollës. Përgatitjet për kopshtin janë shumë të rëndësishme. Kopshti i fëmijëve është edhe angazhimi i prindërve. Prindërit mund të kontribuojnë shumë për rezultate të suksesshme.



Broshura në gjuhë të tjera
mund të shkarkohen këtu.

**Ju falënderojmë me
gjithë zemër, që ju
përkrahni fëmijën tuaj
– fëmija juaj do t'ju
falënderojë!**

Aftësia të qëndrojë pa prindër.....	6
Aftësia të shprehet dhe të kuptojë.....	8
Aftësia të marrë pjesë.....	10
Oferta sporti për fëmijët.....	12
Lojëra për hyrjen në kopshtin e fëmijëve.....	14
Media të reja.....	16
Loja: Labirinti «Min Weg» («Rruga ime»).....	18
Informata që ndihmojnë.....	19

E drejta e autorit: Të gjitha kontributet janë mbrojtur sipas të drejtës së autorëve. Një riprintim i teksteve dhe ilustrimeve – edhe në internet – lejohet vetëm me miratimin shkrimor të botuesit. Me përjashtim të rasteve ligjore, një përpunim pa miratimin e botuesit ndiqet penalisht.

Teksti: Schulen der Stadt Wil

Art Direktion, faqosja: sade creative agency®

Aftësia të qëndrojë pa prindër

Aftësia për t'u shkëputur nga prindërit, kjo duhet të ushtrohet nga mami, babi dhe fëmija.

Flisni tashme sot me fëmijën tuaj për kopshtin e fëmijëve.


1. Jepjani fëmijës tuaj besimin, që ai mund të ndihet mirë në kopsht nga të gjitha anët.
2. Zgjoni kureshtjen dhe gëzimin e tij. Dhurojani atij një çantë për vaktin e mëngjesit, që ai mund ta varë në shtëpi në vendin e vet.
3. Jepjani fëmijës tuaj ndjenjën, që të qenit në kopshtin e fëmijëve është një gjë e mirë, dhe tregoni, që ju jeni krenarë për fëmijën tuaj.
4. Jepjani fëmijës tuaj herë pas here mundësi të kalojë kohë me një person të besueshëm dhe të vlerësuar, pa qenë ju prezent.
5. Informojeni fëmijën tuaj, që ju do ta merrni atë sërish dhe kthehuni me patjetër në orën e caktuar.
6. Përshëndeteni fëmijën tuaj shkurtimisht dhe me vendosmëri. Largohuni me vendosmëri për në shtëpi, edhe kur fëmija juaj qan.

Informata të tjera: Kodet QR për linqet gjinden në faqen 19.


Gjithçka rreth familjes dhe fëmijës: familienleben.ch

Shkolla popullore Kantoni St.Gallen: sg.ch/gesundheits-soziales/soziales/familie/informationen-fuer-familien.html


Ditën nuk kam nevojë
më për pelena.




Unë di të vishem dhe të
zhvishem vetë (p.sh. xhupin,
vijën e kopshtit, dorashkat,
kapuçin dhe rrobat e sportit).



Në mëngjes jam çlodhur
dhe në gjendje për të mësuar
(gjumi i natës pa shqetësime
prej të paktën 10 – 12 orësh).



Di t'i përshëndes prindërit e
mi para derës së kopshtit të
fëmijëve dhe në vijim të hyj vetëm
(tashme që nga dita e parë).



Kam ngrënë mëngjes
para se të mbërrij në
kopshtin e fëmijëve.



Aftësia të shprehet dhe të kuptojë

Kur dikush nuk kupton absolutisht asgjë, kjo gjë sjell frikë dhe trishtim. Fëmija nuk mund të krijojë kontakte me të tjerët dhe ndihet i përjashtuar. Prandaj ai bën mirë të kuptojë pak gjermanisht, kur ai hyn në kopshtin e fëmijëve.

Zhvillimi gjuhësor në moshën e hershme të fëmijërisë ka një ndikim të madh në integrimin social. Një fëmijë që para kopshtit të fëmijëve tashme kupton fjali dhe fjalë të thjeshta në gjermanisht, e ka më të lehtë të krijojë shoqëri dhe të orientohej në grup. Si prindër mund të luani një rol të rëndësishëm këtu. Ndani gjuhët në familje në mënyrë logjike: Prindi, që mund të flasë më mirë gjermanisht, mund të ushtrojë këtë gjuhë me fëmijën, derisa prindi tjetër vazhdon me gjuhën amtare. Synimi nuk është

perfeksioni; qëllimi është që fëmija të mësojë një fjalor bazë. Nëse në familje nuk flitet gjermanisht, grupe lojërash ose kontakti me fëmijë gjermanishtfolës janë alternativa të mira. **Pra prindër të dashur, merrni guximin dhe përkrahni fëmijët tuaj!**

Informata të tjera: Kodet QR për linqet gjinden në faqen 19.

FBBE – Zyra e komunës Wil e specializuar për arsimin, kujdestarinë dhe edukimin në fëmijërinë e hershme: stadtwil.ch/kinder/19186

Grupe lojërash në Wil e përreth: stadtwil.ch

Lexojuni fëmijëve shpesh me zë të lartë, merrni hua libra në gjuhë të ndryshme: stadtwil.ch/stadtbibliothek
Këshilla për zhvillimin gjuhësor në shumë gjuhë: kindersprache.ch, integration.sg.ch


Rime dhe vjersha në shumë gjuhë: elternbildung.ch, buchstart.ch

Këngë popullore për fëmijët: chindermusigwaelt.swissmom.ch

Unë di t'i
shpreh nevojat
e mia.



Kuptoj tashme disi
gjermanisht. Përsëndetje!
Quhem... Vij nga...



Jam në gjendje t'i
kuptoj dhe t'i
zbatoj rregullat.



Jam në gjendje të krijoj
kontakte me fëmijë
të tjerë dhe të zgjedh
konflikte pa dhunë.



Aftësia të marrë pjesë

Fëmija juaj dëshiron të marrë pjesë, që nga dita e parë. Përgatiteni atë për aktivitetet, që ai do të bëjë në kopshtin e fëmijëve.

1. Lini fëmijën tuaj të lozë me lodra formuese, gurë ndërtimi, Lego dhe lojëra me letra. Lozni një herë në ditë me të.
2. Jepjani fëmijës tuaj letër, lapsa, ngjitës dhe gërshërë, që të bëjë punë krijuese, të presë, të vizatojë dhe të ngjisë.
3. Lejoni fëmijën tuaj të të ju ndihmojë gjatë punëve të shtëpisë. Ai mund të shtrojë tavolinën, t'i vadisë lulet, t'i marrë pluhurat, të zbrazë kutinë e postës, të vendosë sende në frigorifer etj. Jepjani fëmijës tuaj mundësi të veprojë me pavarësi sipas motos: «Më ndihmo, që unë ta bëj vetë!»
4. Lejoni fëmijën tuaj të vishet vetë, të shkojë vetë në tualet, t'i lajë duart vetë, të pastrojë hundën vetë etj. Ndhmoni vetëm, kur fëmija nuk mund të vazhdojë dot vetë.
5. Lexojani fëmijës tuaj përditë diçka me zë të lartë ose shikoni një libër së bashku me atë.

Informata të tjera: Kodet QR për linqet gjinden në faqen 19.

Natyra për të luajtur: kinder-4.ch (përkthyer në gjuhë më të ndryshme)

Filma të shkurtër për të nxënësit në shtëpi: mit-kindern-lernen.ch

Film me shumë këshilla për nxitjen e hershme: fruehekindheit-sg.ch


Unë di të merrem me kujdes me lodrat dhe di, që edhe sistemimi i lodrave është pjesë e lojës.



Unë mund të lëviz çdo ditë në ajër të freskët dhe gjatë kësaj kohe mësoj të vrapoj, të ngjitem dhe të mbaj ekuilibrin.




Di të hap dhe të ha bukën time për vaktin e orës nëntë pa ndihmë.



Kuptoj, kur më shkohet në tualet dhe jam në gjendje të shkoj vetë.



Në shtëpi lejohej të fitoj përvoja fillestare duke punuar me gërrshërë, ngjitës dhe lapsa.



Unë di t'i laj duart vetë dhe ta pastrojë hundën vetë.



Ofertat e komunës Wil

Zyra e komunës Wil e specializuar për arsimin, kujdestarinë dhe edukimin në fëmijërinë e hershme (FBBE) A keni pyetje për ofertat para hyrjes në kopshtin e fëmijëve? Zyra e specializuar FBBE me dëshirë është në dispozicionin tuaj.

Oferta sporti për fëmijët

Në Wil theksohet posaçërisht vlera e lëvizjes, e lojërave dhe e sportit në zhvillimin e fëmijës. Për fëmijët nga 4 deri në 8 vjeç hapet një spektër aktivitatesh, të cilat posaçërisht janë drejtuar në nxitjen dhe forcimin e kompetencave sportive. Qoftë në skuadër me futboll dhe hokej mbi dysheme ose veç e veç gjatë alpinizmit dhe jogës për fëmijë – për gjithsecilin qëndron në dispozicion një aktivitet

i përshtatshëm, i cili mundëson zhvillimin fizik dhe social dhe që të kënaqesh gjatë kësaj aktiviteti sa të duash.

Informata të tjera: Kodet QR për linqet gjinden në faqen 19.

Konsultim nënash dhe baballarësh Untertoggenburg-Wil-Gossau: mvbo.ch

Shoqërim adoleshentësh dhe familjesh: stadtwil.ch/sozialestb/19222

Strukturat ditore të komunës Wil: stadtwil.ch/tagesstrukturentheme/19171

sport4kids – Së bashku aktiv, mësim me anë të lojës.

Projekti «sport4kids» i zyrës së specializuar për sportin dhe infrastrukturën mundëson një ofertë sportive për kohën e lirë për fëmijët nga kopshti deri në klasën e gjashtë. Jashtë edukimit fizik në shkollë ata mund të bëjnë aktivitete sportive me shokët, të kënaqen dhe të zbulojnë sporte të reja pa qenë anëtar në një shoqatë. Zhvillimi i gjashtë vazhdon ende deri më datën 5 prill 2024 dhe ofron kurse si Kung Fu për fëmijë, Rock 'n' Roll, joga për fëmijë, alpinizëm, arte japoneze luftarake, trajnim polisportiv, hokey mbi dyshe dhe futboll.

OSSO – palestra të hapura

Për fëmijët e komunës Wil ekziston gjithashtu mundësia e palestrave të hapura të dielën (OSSO). Gjatë kësaj iniciative, komuna i hap palestrat e tyre të dielën me qëllim që t'u japë fëmijëve edhe në dimër një mundësi të lëvizin. Palestrat Klosterweg hapen çdo të dielën e dytë nga ora 13.30 deri në orën 16.30.

Let's Jump

Në ofertën Let's Jump bëhet fjalë për një ofertë vullnetare të edukimit fizik në shkollë. Të gjitha shkollave në Wil iu jepet mundësia për të marrë pjesë në garën e kërcimit me litar. Këtu ka dy kategori: gara individuale dhe gara në skuadër. Gjatë garës individuale, gjithsecili lufton kundër gjithsecilit. Fiton ai, që kryen më shumë kërcime brenda një

minute. Gjatë garës në skuadër, një skuadër kërcen së bashku me një litar të gjatë. Fiton skuadra me më shumë kërcime.

Gara orientuese historike – të qëndroni në lëvizje me zgjuarsi

Në komunën Wil ekziston një sistem i instaluar fiks për gara orientuese, i cili mund të shfrytëzohet gjatë gjithë vitit përjashta. Gara orientuese historike ndodhet afër ndërtesave të ndryshme historike në qytetin e vjetër të Wil-it dhe përreth. Me ndihmën e kodeve QR ka qasje për informata dhe piktura interesante.



Informata të mëtejshme:
stadtwil.ch/publikationen



Informata të mëtejshme:
stadtwil.ch/sporttb

Lojëra për hyrjen në kopshtin e fëmijëve

Lozni me fëmijën tuaj në shtëpi dhe lehtësojani atij në këtë mënyrë hyrjen në kopshtin e fëmijëve. Këtu gjeni disa këshilla të vlefshme. Të gjitha lojërat i gjeni në supermarkete ose në dyqanin e lojërave. Shumica e lojërave mund të merret edhe hua në **ludotekën Wil**. Një instrukcion për lojën gjindet gjithmonë brenda kutisë. Ju lutemi vini re edhe deklaratën për moshën (3+ ose 4+). Kjo ndodhet mbi kutinë.

Natyra ofron shumë mundësi për të fituar përvoja në mënyrë të dobishme.

Dilni me fëmijën tuaj, lejojeni atë të lozë me materiale natyrale, të gërmojë në baltë dhe të vëzhgojë insekte. Fëmija juaj do të zbulojë ide të tjera, me anë të prekjeve do të forcojë ndjesinë e trupit të vet dhe të shpalosë kreativitetin e vet.

Lojëra zbavitëse për moshën 2–5-vjeçare

- revista për prindër Fritz & Fränzi, Lojërat më të dashura për familjen: fritzundfraenzi.ch
- Lojërat më të mira për fëmijët e moshës 2 vjeç e sipër: spiele.tips
- Nxitja dhe ruajtja e funksioneve të trurit me anë të lojërave shoqërore: kispisg.ch
- 24 aktivitete, ku një fëmijë 2–4-vjeçar mund të loz vetëm: powerpausen.ch



Bibliothek e bashkësisë Wil
stadtwil.ch



Ludoteka Wil
stadtwil.ch/ludothek



Mediat e reja

Në botën e sotme më digjitale ka rëndësi, që fëmijëve t'u mundësohen sa më shumë aktivitete të larmishme përjashta.

Ju rekomandojmë:

Deri në moshën 3-4-vjeçare më mirë të hiqet dorë nga koha para ekranit (PC, tablet, TV). Aktiviteteve jashtë dhe lojërave me të tjerët duhet t'u jepet gjithmonë përparësi kundrejt kohës para ekranit. Lojërave të përbashkëta në familje (shih faqen 14) duhet t'u jepet gjithmonë përparësi kundrejt lojërave para ekranit.

Informata të tjera: Kodet QR për linqet gjinden në faqen 19.

jugendundmedien.ch/empfehlungen (edhe në gjuhë të tjera)

kinderschutzzentrum.ch/de/zusatzmaterial-cohaco/linkliste_eltern

projuventute.ch/de/eltern/medien-internet

Kur fëmijët tuaj shfrytëzojnë mediat e reja, ju lutem vini re këto këshilla dhe rekomandime:

1. **Përkraheni fëmijën tuaj në botën digjitale**

Në peizazhin e mediave, fëmijët kanë nevojë për drejtim dhe bisedime me prindërit e tyre. Komunikohapuri me ta për këtë temë!

2. **Kini kujdes për rolin tuaj si shembull**

Prindërit dhe persona të tjerë referues janë shembuj për fëmijët në lidhje me shfrytëzimin e mediave. Prandaj shqyrtoni zakonet tuaja individuale me mediat!

3. **Fëmija e vogël dhe mediat digjitale**

Fëmijët e vegjël kanë nevojë në radhë të parë për ngrohtësi, por edhe lëvizje si dhe kohë për lojëra të lira dhe zbulime. Shfrytëzimi i mediave me ekrane para kohës së gjumit vështirëson vënien në gjumë.

4. **Caktoni periudha për shfrytëzimin e ekraneve**

Nën 3 vjeç: nuk lejohet kohë para ekranit. Mosha 3- deri 5-vjeçare: deri në 30 min. në ditë dhe me shoqërim. Mosha 6- deri 9-vjeçare: deri në 45 min. kohë para ekranit në ditë. Mosha 10- deri 12-vjeçare: deri në 60 min. kohë para ekranit në ditë

5. **Vini re kufizimet e moshës**

Kujdesuni për kufizimet e moshës për filma (si FSK) dhe lojëra (si PEGI, USK) dhe mendohuni gjithashtu,

nëse përmbajtjet janë të përshtatshme për fëmijën tuaj.

6. **Mediat nuk zëvendësojnë një kujdestari fëmijësh**

Mediat digjitale nuk duhet të përdoren për qetësimin e fëmijëve ose për t'u hequr mendjen atyre. Përfshini fëmijët tuaj në punët e përditshme, gjithmonë kur kjo është e mundur.

7. **Biseda e hapur me fëmijën tuaj është më e rëndësishme se përdorimi i softuerit filtrues**

Është vendimtar, që rreth përmbajtjeve çorientuese të bisedoni në mënyrë të përshtatshme me moshën e fëmijës dhe kështu të krijoni një bazë komunikimi besimplotë.

8. **Shmangni televizorë si dhe kompjuterë, laptope dhe tableta në dhomën e fëmijës!**

9. **Rëndësia e mediave për zhvillimin gjuhësor të fëmijës**

Një zhvillim pozitiv gjuhësor tek fëmijët ndodh mbi të gjitha përmes komunikimit direkt me persona të tjerë. Media elektronike vetë nuk mjaftojnë për t'ua transmetuar fëmijëve mësimin e gjuhës në mënyrë optimale.

Lojëra me labirinte janë të shkëlqyera për zhvillimin e fëmijës: Ato nxisin aftësitë për zgjedhje problemesh dhe kuptimin hapësinor, përmirësojnë shkathtësinë dhe koordinimin midis syve dhe dorës, mësojnë durim dhe qëndrueshmëri dhe forcojnë funksionet kognitive. Fëmijët mësojnë të marrin vendime dhe besimi në vetveten rritet tek ata me çdo sfidë të kaluar me sukses.

Jani kërkon shokun e tij për të luajtur. Ku është rruga?



**Gjithëka rreth
familjes de fëmijës
në shumë gjuhë**

familienleben.ch



**Konsultim nënash
dhe baballarësh
mvbo.ch**



**Shoqërim
adoleshentësh dhe
familjesh, stadtwil.ch**



**Strukturat ditore të
komunës Wil, stadtwil.ch**



**Shkolla popullore e
Kantonit St.Gallen, sg.ch**



**FBBE – Zyra e komunës
Wil e specializuar për
arsimin, kujdestarinë
dhe edukimin në
fëmijërinë e hershme**

stadtwil.ch



**Zhvillimi gjuhësor
në shumë gjuhë**

integration.sg.ch



kindersprache.ch



**marrja hua e librave
në shumë gjuhë**

**Biblioteka e komunës
stadtwil.ch/
stadtbibliothek**



**Ludoteka Wil
stadtwil.ch/ludothek**



**Rime dhe vjersha
në shumë gjuhë**

elternbildung.ch



buchstart.ch



**Këngë popullore
për fëmijët**

chindermusigwaelt.
swissmom.ch



**Mediat dhe adoleshenca
në shumë gjuhë**

jugendundmedien.ch



kinderschutzzentrum.ch



projuventute.ch



Lojëra & nxitja

**Natyra për të luajtur
kinder-4.ch**



**Filma të shkurtër për të
nxën timer në shtëpi
mit-kindern-lernen.ch**



**Këshilla për nxitjen e
hershme
fruehekindheit-sg.ch**



**Grupe lojërash në
Wil dhe përreth**

stadtwil.ch

